



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 19 (827771)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 13 Maj 2022

Gjeneralmajor Begaj: Mirënjohje e trupave shqiptare, pjesë e grup-batalionit, kontributi i ynë do të vijojë edhe në të ardhmen

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të SFARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim komandantin e Task-Forcës (TF) - Letoni, kolonel Jean-Francois Cauden. Në fjalën e tij në takim, gjeneralmajor Begaj vlerësoi rolin e komandës së TF-Letoni si pjesë e masave të sigurisë së NATO-s me prezencë të përparuar përgjatë kufirit lindor të Aleancës. "Pas agresionit të paprecedentë dhe të pajustificuar që Rusia ka ndërmarrë në Ukrainë së

fundmi, ne jemi më të bindur se kurrë se prezenca e përparuar e NATO-s në kufirin lindor të saj, nuk është thjesht një opsion, por një domosdoshmëri për të garantuar sigurinë e aleatëve", -u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Begaj në fjalën e tij. Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj falënderoi kolonel Cauden dhe zinxhirin e komandimit të grup-batalionit të Përparuar të NATO-s të dislokuar në Letoni, për mbështetjen e vazhdueshme që ka

dhënë për trupat shqiptare pjesë e grup-batalionit, duke e garantuar atë se kontributi i Shqipërisë do të vijojë edhe në të ardhmen. Nga ana e tij, komandanti i TF-Letoni, kolonel Cauden vlerësoi rolin dhe kontributin e Shqipërisë në sigurinë e kufirit lindor të Aleancës, si dhe theksoi profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar nga ushtarakët shqiptarë pjesëmarrës në mision në Letoni. Komanda e Task-Force-Letoni ushtron komandim-kontrollin... >>> faqe 2



TRAJNIMI I EFEKTIVËVE TË FT NGA SFAB

Ministri Peleshi: Me këtë ecuri trajnimesh, jam i bindur se do të marrim certifikimin e kapacitetit tonë të deklaruar në NATO



Forcat Tokësore vijojnë trajnimin e rekrutëve të Stërvitjes Individuale Bazë (SIB)

Në Forcën Tokësore vijon trajnimi i rekrutëve të Stërvitjes Individuale Bazë (SIB). Stërvitja Individuale Bazë është kursi që certifikon ushtarët e rinj, të cilët do të shërbejnë në Forcat e Armatosura. Forca Tokësore mban në gatishmëri kapacitetet e nevojshme operationale për ruajtjen dhe mbrojtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Shqipërisë. Forca Tokësore si njësi prioritare në strukturën e Forcave të Armatosura...



>>> Faqe 4

Migrim apo emigrim, plagë e shoqërisë shqiptare me gjurmë historike

Rënia e sistemit totalitar në Shqipëri filloi përmes një lëvizjeje sociale të fuqishme siç ishte Lëvizja studentore e dhjetorit e vitit 1990, e cila, në bashkëpunim edhe me faktorë dhe aktorë të tjerë të shoqërisë shqiptare, u shndërrua shpejt në një lëvizje të mirëfilltë politike që prodhoi edhe të parën parti politike opozitare në vend dhe legjitimoi kështu, pas gati 50-vjetësh, pluralizmin politik dhe sistemin e ri politiko-ekonomik të mbështetur tek demokracia liberale dhe ekonomia e tregut. Lëvizja e studentëve të dhjetorit...



>>> Faqe 5

10 tendencat dhe inovacionet e teknologjisë ushtarake për vitin 2022

Sistemi ushtarak global po përjeton transformime të rëndësishme dhe po përdor tendencat e teknologjisë për të forcuar aftësitë. Tendencat kryesore përfshijnë inteligjencën artificiale (AI), robotikën dhe internetin e gjërave (Internet of Things-IoT), për të optimizuar operacionet e mbrojtjes dhe për të rritur efikasitetin ushtarak. Sot, lufta konvencionale po zëvendësohet gjithnjë e më shumë nga qasje hibride që kombinojnë gjithashtu luftën kibernetike dhe kufijtë e tjerë. Tendencat në zhvillim të teknologjisë ushtarake po ndryshojnë fushën e betejës në katër aspekte: lidhshmëri, vdekshmëri...



>>> Faqe 6-7

GJENERALMAJOR PROF. ASOC. BEGAJ PRET NË TAKIM KOMANDANTIN E TF-LETONI, KOLONEL CAUDEN

Gjeneralmajor Begaj: Falënderimet tona për mbështetjen e vazhdueshme ndaj trupave shqiptare, pjesë e grup-batalionit, kontributi i Shqipërisë do të vijojë edhe në të ardhmen

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim komandantin e Task-Forcës (TF) - Letoni, kolonel Jean-Francois Cauden.

Në fjalën e tij në takim, gjeneralmajor Begaj vlerësoi rolin e komandës së TF-Letoni si pjesë e masave të sigurisë së NATO-s me prezencë të përparuar përgjatë kufirit lindor të Aleancës.

“Pas agresionit të paprecedentë dhe të pajustificuar që Rusia ka ndërmarrë në Ukrainë së fundmi, ne jemi më të bindur se kurrë se prezencja e përparuar e NATO-s në kufirin lindor të saj, nuk është thjesht një opsion, por një domosdoshmëri për të garantuar sigurinë e aleatëve”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Begaj në fjalën e tij.

Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj falënderoi kolonel Cauden dhe zinxhirin e komandimit të grup-batalionit të Përparuar të NATO-s të dislokuar në Letoni, për mbështetjen e vazhdueshme që ka dhënë për trupat shqiptare pjesë e grup-batalionit, duke e garantuar atë se kontributi i Shqipërisë do të vijojë edhe në të ardhmen.

Nga ana e tij, komandanti i TF-Letoni, kolonel Cauden vlerësoi rolin



dhe kontributin e Shqipërisë në sigurinë e kufirit lindor të Aleancës, si dhe theksoi profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar nga ushtarakët shqiptarë

pjesëmarrës në mision në Letoni.

Komanda e Task-Force-Letoni ushtron komandim-kontrollin e trupave kanadeze pjesë e grup-



GJENERALMAJOR BEGAJ

“Pas agresionit të paprecedentë dhe të pajustificuar që Rusia ka ndërmarrë në Ukrainë së fundmi, ne jemi më të bindur se kurrë se prezencja e përparuar e NATO-s në kufirin lindor të saj, nuk është thjesht një opsion, por një domosdoshmëri për të garantuar sigurinë e aleatëve”, - tha gjeneralmajor Begaj në fjalën e tij.

batalionit të përparuar të NATO-s nën drejtimin kanadez në Letoni, në të cilin Shqipëria kontribuon që prej vitit 2017 me një togë EOD.

Vizita e komandantit të “TF-Letoni” në Shqipëri vijoi me takime pune në Shtabin e Përgjithshëm dhe Komandën Mbështetëse.

TAKIMI

Komandanti i Task-Forcës së Letonisë, vizitë në Komandën Mbështetëse

Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebxhia priti në një takim të veçantë Komandantin e Task-Forcës së Letonisë në prezencën e përparuar të NATO-s (enhanced Forward Presence), kolonel Jean-Francois Cauden.

Qëllimi i kësaj vizite ishte paraqitja e arritjeve të deritanishme të grup-batalionit nën drejtimin kanadez,

roli i Task-Forcës së Letonisë, arritjet e deritanishme të Kontingjentit të X EOD, si pjesë përbërëse e grup-batalionit kanadez si dhe forcimi i bashkëpunimit të ndërsjellë.

Komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Xhebxhia, pasi i uroi mirëseardhjen Kolonel Cauden-it e njohu me kontributet e Komandës Mbështetëse dhe në veçanti me kompaninë EOD.



Në takim u diskutuan çështje në lidhje me sfidat e së ardhmes, rolin e kontingjentit EOD si pjesë përbërëse e grup-batalionit Kanadez. Nga ana e tij Komandanti i Task-Forcës së Letonisë, kolonel Cauden, falënderoi Gjeneral Xhebxhinë për pritjen e ngrohtë dhe vlerësoi rolin e kontingjentit EOD për kontributin e tyre të çmuar për Aleancën.



STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni “Skënderbej”



Trajnimi i efektivëve të FT nga SFAB: Presim certifikimin nga NATO

Ministri Peleshi: Me këtë ecure trajnimesh, jam i bindur se do të marrim certifikimin e kapacitetit tonë të deklaruar në NATO

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi ndoqi nga afër një ditë nga trajnimi i efektivëve të Forcës Tokësore nga një grup i Brigadës së Sigurisë dhe Trajnimit të Komandës Europiane të SHBA-së (SFAB).

Ministri Peleshi tha se ky trajnim i shërben rritjes së nivelit të forcave të Armatosura shqiptare, si pjesë e NATO-s dhe certifikimit, në shtator nga Aleanca.

“Ne kemi një kapacitet të deklaruar në NATO të dislokueshëm në raste operacionesh, në raste nevojash, që është Grup - Batalioni i Këmbëorisë. Natyrisht na duhet vazhdimisht të trajnohemi dhe të mbajmë standardet e kërkuara nga NATO e për këtë kemi nevojë për asistencë. Kemi asistencë të vyer nga partneri strategjik SHBA-të, të cilët përmes Brigadës së Sigurisë dhe Trajnimit punojnë bashkë me Forcën Tokësore, Grup - Batalionin e Këmbëorisë (GBKL) për t'i ngritur në nivelin që kërkon NATO. Në shtator jemi të bindur që me sa po shohim, me ecurinë e këtyre stërvitjeve, trajnimeve ne do të marrim me sukses certifikimin e kapacitetit tonë të deklaruar në NATO”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi.

Nga ana e tyre komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji si dhe kapiten Peter Habsburg, drejtues i brigadës dhanë më shumë detaje rreth trajnimit.

Aktualisht në Zall - Herr është akomoduar një ekip i SFAB, në përbërje të të cilit ka ekspertë të fushave të ndryshme (artileri, shëndetësi, ndërlidhje, taktikë, logjistikë, xheniere, përgatitje shtabi, etj.), që do të sigurojnë asistencë të specializuar për GBKL. Ata do të qëndrojnë për një periudhë 6-mujore me rrotacion.

Gjatë kësaj vizite u ndoqën nga afër sekuenca të trajnimeve stërvitore nga efektivët e Batalionit të Dytë të Këmbëorisë si dhe u ekspozuan pajisje të ndryshme.



Trajnimi

Forca TOKËSORE



REPUBLICA E SHQIPËRISË

Forca Tokësore mban në gatishmëri kapacitetet e nevojshme operacionale për ruajtjen dhe mbrojtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Shqipërisë.



Në Forcën Tokësore vijon trajnimi i rekrutëve të Stërvitjes Individuale Bazë (SIB).

Stërvitja Individuale Bazë është kursi që certifikon ushtarët e rinj, të cilët do të shërbejnë në Forcat e Armatosura.

Forca Tokësore mban në gatishmëri kapacitetet e nevojshme operacionale për ruajtjen dhe mbrojtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Forca Tokësore si njësi prioritare në strukturën e Forcave të Armatosura, ka angazhime në operacione të emergjencave civile në ndihmë të komunitetit në rast fatkeqësish natyrore, si përmytje, zhbllokim rrugësh dhe shpërndarje ndihmash në rast reshesh dëbore, operacione shuarje zjarresh, bashkëpunon me institucione të tjera kombëtare në ndalimin e trafikimit ilegal, të kontrabandës, personave, armëve konvencionale, në Shqipëri.

Trajnon, stërvit dhe merr pjesë me trupa në misionet e mbështetjes së paqes në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Forcat Tokësore vijojnë trajnimin e rekrutëve të Stërvitjes Individuale Bazë (SIB)



QAPU

DHURO GJAK, SHPËTO JETË

Në QAPU u organizua dita e dhurimit të gjakut.

Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve, Bunavi i është bashkuar kauzës për dhurim gjaku, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut me moton: #kushdhurongjakshpëtonjetë.

51 efektivë nga personeli dhe kursantë të kësaj Qendre dhuruan gjak për njerëzit në nevojë.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Rënia e sistemit totalitar në Shqipëri filloi përmes një lëvizjeje sociale të fuqishme siç ishte Lëvizja studentore e dhjetorit e vitit 1990, e cila, në bashkëpunim edhe me faktorë dhe aktorë të tjerë të shoqërisë shqiptare, u shndërrua shpejt në një lëvizje të mirëfilltë politike që prodhoi edhe të parën parti politike opozitare në vend dhe legjitimoi kështu, pas gati 50-vjetësh, pluralizmin politik dhe sistemin e ri politik-ekonomik të mbështetur tek demokracia liberale dhe ekonomia e tregut. Lëvizja e studentëve të dhjetorit kishte karakteristikat e një lëvizjeje sociale që u nxit nga një grup social me vetëdije të lartë atdhetare, siç ishte rinia studentore, dhe që përfundoi me realizimin e misionit të saj historik, nxitjen e ndryshimeve nga poshtë-lart dhe krijimin e situatave që bënë të mundur lejimin e pluralizmit politik. Shqipëria e pas viteve 90' ka përjetuar disa 'valë të lëvizjeve sociale', që kanë qenë të lidhura me ciklet politike të qeverisjes dhe kanë prodhuar situata, faktorë dhe vendimmarrje, ku janë përfshirë çështje të keq-qeverisjes së sistemeve zgjedhore, mbrojtjes së mjedisit e trashëgimisë kulturore, arsimit, të drejtave sociale etj. Rrjedhojë e këtij arsytimi, 'vala e parë e lëvizjeve sociale (qytetare)' në Shqipëri lidhet me periudhën 1990-1997, 'vala e dytë e lëvizjeve sociale' përkon me periudhën 1998-2005, 'vala e tretë e lëvizjeve sociale' ka qenë e lidhur me periudhën e viteve 2005-2013, ndërsa 'vala e katërt dhe e pestë' e lëvizjeve sociale shënohet nga periudha e viteve 2013-2017 dhe 2017-2020.


Te gjithë ne që jetojmë në Shqipëri jemi dëshmitarë të lëvizjeve të mëdha demo-grafike dhe flukseve migratore në vend pas viteve 90-të. Nga një ndalim total i lëvizjes së lirë, u çdo gjë kontrollohej nga shteti, u kalua në një shpërngulje masive të popullsisë që jetonte në fshat pranë qendrave të mëdha urbane. Kjo zhvendosje pati një kosto të madhe për shoqërinë shqiptare dhe u shoqërua nga probleme, konflikte dhe ngjarje të pa ndodhura dhe të paparashikuara më parë. Problemi më akut që edhe sot e kësaj dite nuk po gjen një zgjidhje optimale është çështja e pronës. U zaptuan toka që u përkisnin pronarëve të ligjshëm, u vetë-shpallën pronarë të ligjshëm shpesh njerëz që ua shitën tokat të ardhurave, u ngritën lagje të tëra në periferi të qyteteve pa infrastrukturën e nevojshme dhe pa zbatuar ligjet e urbanistikës, çka solli një kaos të vërtetë në çdo pikëpamje. Konfliktet për çështjen e pronës jo rrallë përfunduan në gjakderdhje, madje edhe brenda familjes. Këto dhe shumë çështje të tjera e kanë ndërlikuar realitetin shqiptar shpesh aq shumë, sa njerëzit e shohin si të pashpresë daljen nga kaosi dhe ndërtimin e një jete ku forca e ligjit do të mbizotërojë mbi çdo gjë tjetër dhe ku veprimi i çastit do t'ia lërë vendin zgjidhjeve të studiuar në bazë të strategjive të qarta të zhvillimit.

Migracioni është shndërruar tashmë në një dukuri globale që në një formë a një tjetër prek të gjithë shtetet në mbarë botën. Dimensionet dhe ndikimi i tij janë të konsiderueshme si në aspektin shoqëror dhe atë individual. Sikundër ndodh rëndom me fenomene të këtij lloji, paralelisht është zhvilluar një korpus normativ

Emigracioni ka një ndikim të madh në zhvillimin profesional të shtetasve shqiptarë. Nga njëra anë, punësimi i emigrantëve shqiptarë në ekonomitë e zhvilluara të vendeve pritëse i ka pajisur ata me një kulturë të përgjithshme të menaxhimit të punës, të etikës në punë, njohuri për sektorë të rinj të ekonomisë, me njohuri mbi teknikën dhe teknologjinë e fundit.

Lëvizjet e mëdha

Migrim apo emigrim, plagë e shoqërisë shqiptare me gjurmë historike



Burimi: INSTAT

për rregullimin dhe menaxhimin sa më mirë të migracionit, si në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe atë kombëtar.

Emigrimi apo migrimi drejt një jete më të mirë ka të mirat dhe të këqijat e veta, pra gjërat duhet të shihen në këndvështrim të ndryshme.

Migracioni gjithashtu përbën një aspekt të rëndësishëm të marrëdhënieve të Shqipërisë me shtetet anëtare të Bashkimit Europian si vende destinacioni për shumicën e emigrantëve shqiptarë. Sigurisht që kjo periudhë tranzicioni solli edhe pasojë ekonomike dhe sociale. Kështu, popullsia është duke u ulur: rritja e saj natyrore në 2001 ishte 12/1,000 dhe niveli i lindshmërisë 18/1,000, krahasuar me 19.6/1,000 dhe 25.2/1,000 në 1990. Raporti i popullsisë totale që jeton në qendra urbane, 36% në 1991 në 49% sot. Kjo shënon një nivel të lartë emigrimi të brendshëm në një harkore zonë të thella rurale-qendra rurale -qendra urbane. Kuptohet se ky migrim i brendshëm, spontan, i paplanifikuar nuk gjeti institucione dhe shërbimet e duhura, duke u kthyer në "paradhomën" e migrimit ndërkombëtar.

Emigracioni është mjet bashkëveprimi në qytetërimin modern. Ne jemi të vonuar në këtë proces që shoqërohet edhe me dëshpërim për lënie e vendit që e duam aq shumë. Zhgënjim është se ende jemi shumë të papërgatitur për t'u përfshirë si duhet në procesin e integritimit me botën e qytetëruar.

Emigrimi më tepër pozitiv apo negativ?

Është e vetmja rrugë sot për të shkurtuar distancën me pjesën tjetër që ka kapërcyer prapambetjen tonë me kohë. Emigracioni është ëndërr dhe zhgënjim njëkohësisht. Por do të vazhdojë të mbetet një plagë e shoqërisë shqiptare edhe për sa kohë

situata ekonomike të ne të mbetet e vështirë, dhe fatkeqësisht, me sa duket kjo do të vazhdojë për shumë vjet.

A është i dhimbshëm emigracioni dhe sa ndikon në jetën e emigrantëve?

Po, shumë, mirëpo njeriu duhet të gjejë mundësinë si të adaptohet dhe të integrohet sa më shpejt në shoqërinë ku jeton, në mënyrë që nga atje në mënyra të ndryshme ta ndihmojmë vendlindjen. Pra, të jemi më pak sentimentalë e më shumë real. Emigracioni është shpesh për fëmijët tanë, por është një zhgënjim shumë i madh për prindërit.

Emigracioni është fotografia më e poshtër e shekullit që e lamë pas për shqiptarët. Nuk ka asnjë komunitet që jeton në këtë rajon e që është lakuruar aq fort sikur shqiptarët.

Emigracioni, kurrë nuk ka qenë diçka anti-popullor. I tillë mund të jetë nëse ata që gjenden në shtetin amë nuk interesohen për ata që gjenden në emigracion.

Konkluzione

Një dhjetëvjeçar pas tranzicionit politik në Shqipëri, që e kthen vendin nga një ekonomi e planifikuar në një ekonomi të tregut të lirë, pamja e Shqipërisë ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Thyerja e izolacionizmit politik dhe ekonomik, i imponuar nga regjimi komunist, solli në jetë probleme të shoqërisë dhe me karakter ekonomik, të cilat kontribuan në shtimin e lëvizshmërisë së popullsisë në hapësirë. Ngjarjet e turbullta politike që pasuan procesin e demokratizimit, kompromentuan zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe, për rrjedhojë, e zhytën një pjesë të madhe të shoqërisë në varfëri. Për shkak të infrastrukturës së vjetruar të industrisë shqiptare, prodhimi industrial u pakësua në mënyrë të konsiderueshme pas tranzicionit, madje në disa raste këto industri u

detyruan të mbyllen.

Privatizimi i bujqësisë rriti prodhimin bujqësor nga njëra anë, por krijoi edhe një sërë problemesh – si copëtimin e tokës në zonat periferike apo malore – nga ana tjetër. Punimi i këtyre copëzave të tokës nuk mundësoi mbijetesën e familjeve dhe i detyroi ato të kërkojnë burime të ndryshme të të ardhurave. Pra, këto transformime politike dhe ekonomike patën një ndikim të konsiderueshëm mbi demografinë shqiptare.

Analiza e regjistrimeve të popullsisë tregon se në periudhën midis 1989 e 2001 u largua nga vendi rreth 20% e popullatës, ndërsa 8% u zhvendos në një tjetër prefekturë. Meqenëse procesi i demokratizimit u ofroi shqiptarëve mundësi më të mira për migrim dhe për shkak të moshës së re të popullsisë në vitin 1989, për herë të parë në shumë dhjetëvjeçarë u vu re një rënie demografike. Megjithatë, jo të gjitha rrethet e Shqipërisë e përjetuan këtë migrim dhe evolucion demografik me të njëjtin intensitet.

Ndërkohë që zhvendosjet e para brenda për brenda vendit midis prefekturave u drejtuan për nga qendra kryesore e vendit – zonat e rëndësishme ekonomike dhe bregdetare të Tiranës dhe Durrësit thithën 72% të kësaj zhvendosjeje – si dhe për në qendrat e tjera dytësore apo porte detare, veçanërisht në Fier, Vlorë dhe Lezhë, disa prefektura të tjera, veçanërisht ato të lokalizuara në thellësi të veriut, humbën deri në 34% të popullsisë së tyre të regjistruar në 1989, për shkak të dukurisë së migrimit të brendshëm. Rrethet jugore shfaqin një nivel të moderuar të migrimit. Në fakt, banorët e veriut migruan kryesisht brenda vendit, ndërsa ata që vinin nga zonat jugore apo qendrore kishin prirje për t'u larguar jashtë vendit.

Nëse do të lidhim si duhet migrimin me zhvillimin atëherë do ta bëjmë këtë dukuri të vyer për ne. Sidoqoftë, ky proces ka edhe anën tjetër të medaljes, p.sh. migrimi mund t'i privojë vendet e origjinës nga aftësitë më të mira dhe talentet dhe mendjet e shkëlqyera, siç mund të ndikojë në copëtimet/shpërbërjet e familjes; jo rrallë migrimi shfrytëzohet për qëllime kontrabandimi dhe trafikimi të qenieve njerëzore për të shkuar deri tek shfrytëzimi i flukseve migratore nga organizata kriminale dhe terroriste. Asnjëherë nuk është e tepërt të pohohet dhe ripohohet se shumë prej problemeve mund të zgjidhen, përmes angazhimit, debatit, si brenda vendit duke përfshirë të gjithë aktorët kyç, ashtu edhe përmes një bashkëpunimi ndërkombëtar. Kjo do të shpinte në një njohje dhe të kuptuar më të mirë të përfitimeve dhe volive të pamasa që ofron migrimi. Emigracioni ka një ndikim parësor në ekonominë e vendit si rezultat i dërgesave të emigrantëve. Dërgesat e emigrantëve përbëjnë një nga shtyllat kryesore të ekonomisë shqiptare duke siguruar një hyrje të vazhdueshme të valutave të huaja në vend si edhe duke konsoliduar bazën për kursime dhe investime.

Mbështetur në të dhënat zyrtare kontributi i dërgesave të emigrantëve, për një periudhë 10-vjeçare është vlerësuar rreth 15% e Produktit të Brendshëm Bruto. Gjithashtu kontributi i këtyre dërgesave në bilancin tregtar, për një periudhë 10-vjeçare, vlerësohet të jetë rreth 58.8%.

Ndikimet e emigracionit në tregun e punës

Emigracioni ka një ndikim të madh në zhvillimin profesional të shtetasve shqiptarë.

Nga njëra anë, punësimi i emigrantëve shqiptarë në ekonomitë e zhvilluara të vendeve pritëse i ka pajisur ata me një kulturë të përgjithshme të menaxhimit të punës, të etikës në punë, njohuri për sektorë të rinj të ekonomisë, me njohuri mbi teknikën dhe teknologjinë e fundit. E parë në këtë këndvështrim, kthimi i tyre do të shoqërohej me transferimin e aftësive të sipërpërmendura.

Është gjithashtu fakt se shumë emigrantë nuk punojnë në pozicione për të cilat ata kanë studiuar apo janë trajnuar dhe kjo është arsyeja që lehtësimi dhe nxitja e njohjes së diplomave dhe kualifikimeve shqiptare jashtë vendit është një problem shqetësues. Mundësitë për të emigruar ulin nivelin e papunësisë dhe si pasojë zbusin vështirësitë social-ekonomike që do të shfaqeshin nëse nuk do të ekzistonte mundësia për të kërkuar punë jashtë vendit.

Teknologjia po i jep formë mënyrës sesi zhvillohen luftërat, mbrohen kufijtë, kapen ligjshkelësit dhe përcaktohen të drejtat individuale



10 tendencat dhe inovacionet e teknologjisë ushtarake për vitin 2022



Sistemi ushtarak global po përjeton transformime të rëndësishme dhe po përdor tendencat e teknologjisë për të forcuar aftësitë. Tendencat kryesore përfshijnë inteligjencën artificiale (AI), robotikën dhe internetin e gjërave (Internet of Things-IoT), për të optimizuar operacionet e mbrojtjes dhe për të rritur efikasitetin ushtarak. Sot, lufta konvencionale po zëvendësohet gjithnjë e më shumë nga qasje hibride që kombinojnë gjithashtu luftën kibernetike dhe kufijtë e tjerë. Tendencat në zhvillim të teknologjisë ushtarake po ndryshojnë fushën e betejës në katër aspekte: lidhshmëri, vdekshmëri, autonomi dhe qëndrueshmëri. Zgjidhjet e lidhshmërisë adresojnë shqetësimet se si luftëtarët zbulojnë dhe lokalizojnë kundërshtarët e tyre, komunikojnë me njëri-tjetrin dhe drejtojnë operacionet. Përparimet në teknologjitë e raketave dhe armëve rrisin vdekshmërinë, duke i bërë operacionet në fushëbetëje më efektive. Në frontin e autonomisë, startup-et përdorin robotikën dhe inteligjencën artificiale për të ekzekutuar vendime me ndërhyrje njerëzore zero ose minimale. Së fundmi, startup-et po përmirësojnë qëndrueshmërinë në industrinë e mbrojtjes me teknologji si prodhimi i aditivëve dhe elektrifikimi.

Rezultati i këtij hulumtimi nga "StartUs Insights" është inteligjenca e inovacionit e drejtuar nga të dhënat që përmirëson vendimmarrjen strategjike duke iu dhënë një përmbledhje të teknologjive dhe startup-eve në zhvillim në industrinë e teknologjisë së pastër.

Inteligjenca artificiale (AI) është një nga tendencat më të spikatura pasi shumë kombe dhe kompani po shpenzojnë gjithnjë e më shumë për kërkimin e AI. Industria po shpik gjithashtu armë të reja dhe teknologji shtesë. Në mënyrë të ngjashme, robotika dhe sistemet autonome të armëve përmirësojnë efektivitetin luftarak të ushtrisë, si dhe ndikojnë në tendencat e tjera në industri. Gjithashtu, ka një rritje të konsiderueshme në përdorimin e teknologjive IoT si sensorët, pajisjet e veshura dhe llogaritja e skajshme. Hapësira kibernetike është një tjetër front në zhvillim dhe startup-et zhvillojnë zgjidhje si për sulmet kibernetike ashtu edhe për mbrojtjen kibernetike. Për më tepër, teknologjitë e thelluara (Deep Tech) gjejnë përdorim në stërvitjen ushtarake dhe gatishmërinë luftarake. Prodhimi i aditivëve rrit kapacitetin e prodhimit për komponentët mbrojtës. 5G është një mundësi thelbësore e lidhjes me shpejtësi ultra të lartë. Për më tepër, duke përdorur blockchain, ndjeshmëria e të dhënave dhe proceseve në ushtri ruhet. Këto të dhëna mbi trendet dhe startup-et kryesore të teknologjisë së pastër, përshkruhen hollësisht në platformën "StartUs Insights".

1. Inteligjenca artificiale (AI)

Miratimi i inteligjencës artificiale në mbrojtje rrit arsyetimin ushtarak kompjuterik për misionet e inteligjencës, mbikëqyrjes dhe zbulimit (ISR). Përdorimi i vizionit kompjuterik

mundëson menaxhimin e sigurisë së pajisjeve dhe fuqizon sistemet autonome të armëve, duke reduktuar kështu viktimat e ushtarëve. Duke përdorur teknologjinë binjake dixhitale dhe mësimin e makinerive, prodhuesit e mbrojtjes testojnë përsëritjet e produkteve të reja ushtarake dhe mundësojnë mirëmbajtjen parashikuese për asetet ushtarake. Me vendosjen e "swarm computing", startup-et po zhvillojnë sisteme inteligjente vetë-organizuese që punojnë në bashkëpunim drejt një objekti strategjik.

"Axon Vision" mundëson Ndërgjegjesimin Situativ të bazuar në AI

Kompania izraelite "Axon Vision" zhvillon një motor vendimmarrës të bazuar në AI. Produkti i startup-it, "Edge360", përdor vizionin kompjuterik për t'u siguruar automjeteve tokësore vetëdije të plotë dhe të automatizuar të situatës. Me një ndërfaqe intuitive të përdoruesit (intuitive user interface-UI) dhe mekanizma të personalizuar alarmi, ai zbulon, klasifikon dhe vlerëson vendndodhjen e kërcënimeve në kohë reale. Zgjidhja e startup-it lejon ekipet taktike të kontrollojnë kërcënimet dhe pengesat në fushë.

"Rebellion" ofron produkte

AI të fokusuar në mision

Kompania "Rebellion" me bazë në SHBA ndërton produkte të inteligjencës artificiale të fokusuar në mision për sektorët e mbrojtjes dhe sigurisë. Fillimi përdor mësimin e makinerive dhe fuqinë e të dhënave për të penguar kërcënimet dhe për të nxitur suksesin e misionit. Produktet e tij softuerike të modelit të abonimit si shërbim përdoren për arritjen e vetëdijes gjithëpërfshirëse të hapësirës së betejës, ekzekutimin e misioneve autonome dhe gatishmërinë kibernetike. Modelet e softuerit me në qendër përdoruesin janë ndërtuar në arkitekturë të hapur dhe, për rrjedhojë, janë të pajtueshme me sistemet ekzistuese të harduerit dhe softuerit.

2. Pajisje të avancuara të mbrojtjes

Ushtria po zhvillon pajisje më të sofistikuara dhe të avancuara të mbrojtjes për t'iu kundërvënë kërcënimeve në zhvillim. Inovacionet që variojnë nga fluturimi hipersonik dhe armët me energji të drejtuar deri tek militarizimi i hapësirës janë duke u zhvilluar. Gjithashtu, industria e mbrojtjes po përafrohet objektivin e saj me arritjen e emetimeve neto zero. Ajo po investon në teknikat e elektrifikimit të fushëbetëjës përmes përdorimit të shtytjeve elektrike në avionët ushtarakë si dhe testimit të karburanteve me hidrogjen. Përveç kësaj, organizatat e mbrojtjes po avancojnë gjithashtu kërkimet në bioteknologji dhe nanoteknologji për krijimin e armaturës vetë-shëruese dhe pajisjeve të tjera.

"Hermeus" zhvillon avionë hipersonikë

Kompania "Hermeus" me bazë në SHBA ndërton aeroplanë me kapacitet 5 Mach. Avioni hipersonik "Quarterhouse" është duke u projektuar për të udhëtuar me një shpejtësi prej mbi 3000 milje në orë. Ai përdor një cikël të kombinuar të bazuar në turbinë (TBCC) dhe ka aplikime ushtarake dhe komerciale. Teknologjia është e aftë të shërbejë në misionet e forcave ajrore për inteligjencë, vëzhgim dhe zbulim.

"Epirus" avancojnë Armët e Energjisë së Drejtuar

Kompania "Epirus" me bazë në SHBA zhvillon sisteme të armëve energjetike të drejtuara. Ai përdor teknologjinë e mikrovalës me fuqi të lartë të përcaktuar nga softueri në gjendje të ngurtë për të mundësuar efekte kundër-elektronike për një sërë rastesh përdorimi. Duke shfaqur një arkitekturë të hapur, produkti integrohet me sistemet ekzistuese tokësore, detare dhe ajrore për mbrojtje me shumë shtresa kundër kërcënimeve autonome. Podet e lehta mundësojnë shkatërrimin e

komponentëve kritikë elektronikë, duke çaktivizuar dronët.

3. Robotika dhe sistemet autonome (RAS)

Mbrojtja e forcave, rritja e ndërgjegjesimit për situatën, zvogëlimi i ngarkesës fizike dhe njohëse të ushtarëve si dhe lehtësimi i lëvizjes në terrene sfiduese janë disa objektiva vendimtare për ushtarakët. Integrimi i teknologjive RAS i lejon ushtarakët të arrijnë këto objektiva dhe të kontrollojnë terrenin, të sigurojnë popullatat dhe të konsolidojnë përfitimet. RAS është gjithnjë e më i rëndësishëm për të garantuar lirinë e manovrimit dhe përmbushjen e misionit me rrezikun më të vogël të mundshëm për ushtarët. Përdorimi i dronëve gjithashtu rrit ndërgjegjesimin e situatës në fushën e betejës. Për më tepër, robotët me shumë misione lehtësojnë pastrimin e minave tokësore, operacionet e kërkim-shpëtimit, asgjësimin e mjeteve shpërthyes dhe mbështetjen logjistike.

"Anduril" zhvillon sistemin ajror pa pilot (UAS)

Kompania me bazë në SHBA "Anduril" ofron një UAS autonome për mbështetje inteligjente ajrore. Produkti "Ghost", është një sistem i avancuar droni, që përdor algoritme të inteligjencës artificiale të skajshme. Është i lëvizshëm nga njeriu, i papërshkueshëm nga uji dhe ka një kapacitet të lartë të ngarkesës, si dhe është në gjendje të kryejë një sërë misionesh në çdo mjedis. "Ghost" ofron aftësi vëzhgimi, inteligjence dhe zbulimi në kohë reale, duke krijuar një pamje më të qartë të përbashkët operative për të marrë vendime të informuara ushtarake.

"Spear" ndërton dronë taktikë

Kompania izraelite "Spear" ofron sisteme të menjëhershme të bazuara në dronë. Dronët taktikë të kësaj kompanie përdorin vizionin kompjuterik, "swarm computing" dhe algoritmet e rrjetit për të arritur epërsinë taktike. Dronët janë

të përshtatshëm për lëshim të menjëhershëm nga deti ose toka me platforma të palëvizshme dhe të lëvizshme me një kapacitet ngarkese deri në një kg. Dronët janë të lehtë për t'u përdorur dhe, për rrjedhojë, kërkojnë trajnim minimal dhe ofrojnë një avantazh taktik për tokën dhe forcat speciale.

4. Interneti i gjërave ushtarake (IoMT)

Aplikimet e IoT në mbrojtje përfshijnë lidhjen e anijeve, avionëve, tankeve, dronëve, ushtarëve dhe bazave operative në një rrjet koheziv. Kjo rrit perceptimin, të kuptuarit në terren, ndërgjegjesimin e situatës dhe kohën e reagimit. "Edge computing", AI dhe 5G mbështesin rrjedhjen e qetë të të dhënave në të gjitha degët e ushtrisë, dhe kjo forcon strukturën e komandës dhe kontrollit. Në IoMT, pajisjet ndijuese dhe llogaritëse të veshura nga ushtarët dhe të ngulitura në pajisjet e tyre mbledhin një sërë të dhënash biometrike statike dhe dinamike.

"Espre Technologies" mundëson komunikimin me rrjet në rrjet (NIN)

"Espre Technologies" është një startup me bazë në SHBA që ofron një grup produktesh sensorë për komunikimin "Network in Network" (NIN). Çipet e startup-it mundësojnë enkriptimin dixhital pa tel të të dhënave së bashku me 10 herë transmetime të njëkohshme. Teknologjia bazë është inteligjenca artificiale e integruar për zbulimin inteligjent të kërcënimit dhe shpërndarjen e spektrit të burimeve inteligjente. Komunikimet agnostike, të sigurta dhe të shkallëzueshme të rrjetit janë ndërtuar për fushën e betejës së gjërave dhe ofrojnë komunikime dydrejtimëshe.

"Geosite" ofron

Inteligjencë Ushtarake

Kompania "Geosite" me bazë në SHBA grumbullon të dhëna nga burime të ndryshme si për analizat njerëzore ashtu edhe për makineritë.

Sistemi ushtarak bashkëpunues i

“Geosite” përdor satelitë, IoT dhe sensorë në terren për të krijuar një pamje të përbashkët operative. Vizualizimi i të dhënave, së bashku me panelet e menaxhimit, ofron avantazhin e epërsisë së informacionit për të planifikuar dhe ekzekutuar operacione. Ai ndihmon forcat në inteligjencën gjithëpërfshirëse për ndërgjegjësimin e situatës, gjurmimin e kërcënimeve, shënjinin e diapazonit dhe hartimin e zonave të synuara.

5. Lufta Kibernetike

Sistemet ushtarake janë shpesh të prekshme ndaj sulmeve kibernetike, të cilat potencialisht mund të çojnë në humbjen e informacionit të klasifikuar ushtarak dhe dëmtim të sistemeve ushtarake. Gjatë disa viteve të fundit, frekuenca dhe ashpërsia e sulmeve kibernetike janë rritur në mënyrë të vazhdueshme. Teknologjia parashikuese e sigurisë përdor sigurinë kibernetike, inteligjencën artificiale dhe automatizimin për të zbuluar kërcënimet e mundshme dhe për t'i ndaluar ato përpara se të ndikojnë në aftësitë mbrojtëse të luftës kibernetike. Siguria e lidhur e pajisjeve ushtarake, mbrojtja kibernetike për institucionet kryesore si dhe siguria bërthamore janë fushat kryesore të fokusit. Ushtarët po zhvillojnë gjithashtu aftësi sulmuese për luftë kibernetike, duke filluar nga malware dhe ransomware deri të sulmet e phishing.

“HarfangLab” ofron zbulim dhe përgjigje të pikës së fundit (EDR)

Kompania franceze “HarfangLab” vendos zgjidhje të mbrojtjes kibernetike për të mbrojtur mjediset kritike të infrastrukturës për mbrojtjen kombëtare. Teknologjia e kompanisë është ndërtuar mbi programim ultra të fortë, duke ofruar shpejtësi të lartë informatike dhe siguri të shtuar. Softueri i tij EDR ndihmon në mbikëqyrjen, zbulimin automatik, hetimin dhe neutralizimin e kërcënimeve kibernetike. Struktura e hapur sipas dizajnit i mundëson softuerit të integrohet lehtësisht me zgjidhjet ekzistuese të sigurisë kibernetike në çdo organizatë.

“Cyber Forza” ofron një Platformë të Unifikuar të Mbrojtjes Kibernetike

Kompania “Cyber Forza” me bazë në SHBA ofron një platformë të unifikuar të mbrojtjes kibernetike. Produkti i “Cyber Forza” ka aftësi mbrojtëse dhe interceptuese. Ndërsa e para trajton kërcënimet e jashtme, e dyta trajton kërcënimet e brendshme. Platforma ofron gjithashtu mohim të shërbimit të shpërndarë të bazuar në AI (DDoS). Për më tepër, ai mundëson monitorimin në kohë reale, mbrojtjen nga mashtrimet nga phishing dhe mbrojtjen nga sulmet e ransomware dhe malware.

6. Teknologjitë gjithëpërfshirëse

Teknologjitë gjithëpërfshirëse e bëjnë të lehtë krijimin e përvojave gjithëpërfshirëse, të përsëritura dhe fleksibël, si p.sh. për trajnime fluturimi ose luftarake. Sipërmarrësit përdorin realitetin virtual (VR) për të ndërtuar mjedisë sintetike trajnimit (STE). Këto përvoja shtojnë stërvitjen konvencionale dhe provën e misionit, duke përmirësuar gatishmërinë e ushtarëve dhe njësisë. Përtej mundësive të trajnimit, realiteti i shtuar (augmented reality-AR) i bën ushtarët në terren më efektivë në misionet e tyre. Syzet e përdorimit ose kufjet e AR-së u ofrojnë ushtarëve informacione për hartën, shënuesit e lëvizjes dhe të dhëna të tjera. Kjo përmirëson vendimmarrjen e situatës



në kohë reale për forcat tokësore.

“GOVRED” mundëson trajnimin e bazuar në VR

Kompania me bazë në SHBA “GOVRED” ndërton zgjidhje trajnimit të bazuara në VR për ushtrinë. Kjo kompani përdor kufjet HTC Vive dhe kodin e personalizuar për të krijuar skenarë që funksionojnë me 90 m² për sekondë. Kjo i lejon përdoruesit të lëvizin rreth një zone prej 25 metrash katrorë, duke ndërvepruar me skenarë të shumtë. Teknologjia e trajnimit e startup-it i ofron ushtrisë një linjë të plotë të trajnimit të armëve të zjarrit dhe simulatorëve luftarakë.

“Red 6” ofron trajnim luftarak të bazuar në AR

Kompania “Red 6” me bazë në SHBA zhvillon Sistemin Ajror “Tactical Augmented Reality” (ATARS), një zgjidhje për stërvitjen luftarake të bazuar në AR. Sistemi kombinon AR dhe inteligjencën artificiale për aplikimet e trajnimit ushtarak luftarak ajror. Ai sjell asete virtuale dhe konstruktive në botën reale, duke i lejuar pilotët dhe operatorët tokësorë të shohin kërcënime sintetike në kohë reale, në mjedisë të jashtme dhe me shpejtësi të lartë. Teknologjia është e shkallëzueshme në operacione me shumë domene dhe ndihmon skuadriljet në rritjen e gatishmërisë dhe vdekjes.

7. Prodhimi i aditivëve

Reduktimi i peshës së pajisjeve mbrojtëse është thelbësor për përmirësimin e performancës në shpejtësi, kapacitet dhe konsum të karburantit. Printimi 3D mundëson prodhimin e komponentëve dhe pjesëve duke përdorur shumë më pak material sesa prodhimi tradicional. Redukton kostot e prodhimit dhe mundëson mundësi të reja inxhinierike të projektimit dhe prodhimit të lokalizuar sipas kërkesës, duke reduktuar barrën logjistike. Për më tepër, ai lehtëson krijimin e kombinimeve të reja materiale për mburoja, veshje ushtarake vetë-ngrohëse dhe municione.

“Accreate Labs” ofron komponentë të shkallës së hapësirës ajrore

Kompania indiane “Accreate Labs” printon komponentë të shkallës së hapësirës ajrore për sektorët e hapësirës ajrore dhe të mbrojtjes. Me prodhimin

e aditivëve, kjo kompani prodhon pjesë komplekse të përdorimit përfundimtar, si dhe vegla prodhimi të personalizuar si pajisje dhe pajisje. Zgjidhjet e startup-it rrisin produktivitetin e fabrikës dhe sigurinë e punëtorëve, si dhe e bëjnë procesin e prodhimit me kosto efektive.

“Rapid Application Group” prodhon pjesë kritike për misionin

Kompania “Rapid Application Group” me bazë në SHBA prodhon pjesë kritike për misionin për industrinë e hapësirës ajrore dhe të mbrojtjes. Kompania ofron një sërë zgjidhjesh të prodhimit të aditivëve, të tilla si sinterizimi selektiv me lazer, modelimi i depozitimit të shkrire, stereolithografia, printimi dixhital me dritë dhe derdhja me injeksion. Qasja e saj e bazuar në aplikacione mundëson prototipimin e shpejtë dhe sigurimin e cilësisë së pjesëve harduerike.

8. Analiza e të dhënave të mëdha

E ardhmja e luftës mbështetet gjithnjë e më shumë në informacionin dhe aftësinë për të nxjerrë njohuri prej tij. Ushtarakët me aftësitë për të nxjerrë të dhënat më jetike, për t'i analizuar ato me saktësi dhe shpejtësi dhe më pas për të shpërndarë me shpejtësi dhe siguri informacionin do të kenë një avantazh strategjik. Analitika e të dhënave të mëdha zhblokton njohuri nga burime të ndryshme të të dhënave për ta bërë këtë. Informatika kuantike gjen aplikacione në kriptanalizë dhe simulime ekzekutimi për vendimmarrje të informuar. Analitika mundëson gjithashtu interpretimin efikas të të dhënave të mbledhura nga infrastruktura IoMT. Për më tepër, analitika parashikuese pengon kërcënimet dhe përmirëson sigurinë dhe efikasitetin e detyrave të rrezikshme.

“Q-CTRL” avanco Informatikën Kuantike

Kompania australiane “Q-CTRL” ofron softuer të bazuar në cloud për të maksimizuar performancën në kompjuterët kuantikë. Ai përdor llogaritjen kuantike për aplikacione të ndryshme të mbrojtjes. Zgjidhja e “Q-CTRL” mundëson analizën kriptografike dhe zbulimin e bazuar në sensorë të strukturave të ngurtësuar nëntokësore dhe sistemeve të fshehura

të armëve. Për më tepër, ai lehtëson navigimin kuantik të përmirësuar në fushat e betejës të mohuara nga GPS përmes përshpejtuesve atomikë.

“Delfox” ofron Teknologji Parashikuese

Kompania franceze “Delfox” ofron teknologji parashikuese për të automatizuar detyrat në mjedisë komplekse, si p.sh. për bashkëpunimin me shumë aktorë. Teknologjia përdor të mësuarit përforcues të thellë për të mësuar nga të dhënat nga situatat e hasura më parë dhe përshtatet në përputhje me rrethanat. Produktet e startup-it mundësojnë manovrimin për mjetet pa pilot dhe zbulimin dhe komunikimin e informacionit përkatës në kohën e duhur tek forcat.

9. Teknologjia 5G

Informacioni i duhur dhe në kohë është jashtëzakonisht i rëndësishëm për operacionet ushtarake. Teknologjia 5G, për shkak të shpejtësisë së saj të shpejtë, përshpejton mbështetjen e vendimeve në kohë reale në ushtri. Ai premtan lidhje hiperkonvergjente dhe rrjete të përmirësuar të sigurta të të dhënave. Kjo mundëson aplikacione të reja komandimi dhe kontrolli dhe riorganizon logjistikën. Më tej, rrjetet 5G lehtësojnë transferimin e sasive masive të të dhënave për të lidhur sensorë dhe armë të largëta në një rrjet të dendur dhe elastik të fushëbetjës. Kjo siguron ndërgjegjësimin e menjëhershëm të situatës, si dhe rrit aftësitë e trajnimit dhe të fushëbetjës.

“Niral Networks” ndërton Infrastruktura Private 5G

Kompania indiane “Niral Networks” ofron infrastrukturë private 5G për lidhjen “last-mile”. Sistemi i tij operativ i rrjetit të hapur dhe të zberthyer, “NiralOS”, lehtëson 5G dhe produktet kompjuterike të shkajshme. “NiralOS” integrohet me çdo harduer të kutisë së bardhë jashtë raftit. Për organizatat e mbrojtjes, infrastruktura 5G mundëson transformim dixhital të shpejtë dhe me kosto efektive në të gjitha frontet.

“WiGL” ofron karikim elektrike pa tela “WiGL” është një kompani me bazë në SHBA që ofron karikim elektrik

pa tel nëpërmjet energjisë së synuar përmes ajrit. Teknologjia e patentuar e kësaj kompanie përdor një rrjet transmetuesish pa tel. Ai konverton çdo prizë muri, karikues automjeti ose burim energjie në një ruter inteligjent të energjisë elektrike. Komunikimi kryhet pajisje me pajisje duke përdorur 5G ose Wifi. Me karikimin me valë, pajisjet IoMT nuk varen më nga disponueshmëria e baterive.

10. Blockchain

Blockchain ofron sigurinë e të dhënave duke lejuar që të dhënat përkatëse të ndahen me të gjitha palët e interesuara. Kjo është arsyeja pse startup-et e mbrojtjes po ndërtojnë zgjidhje të bazuara në blockchain për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale ushtarake dhe kundër kërcënimeve kibernetike. Aplikime të tjera të teknologjisë blockchain në industri përfshijnë gjurmimin e pajisjeve, thjeshtimin e procesit të prokurimit dhe sigurinë e zinxhirit të furnizimit. Kontratat inteligjente reduktojnë ndjeshëm rrezikun e mashtrimit ose korrupsionit kur merreni me kontraktorët e mbrojtjes.

“Taekion” mundëson mbrojtjen e të dhënave ushtarake

Kompania “Taekion” me bazë në SHBA zhvillon teknologji për mbrojtjen e të dhënave ushtarake. Ai përdor blockchain për të siguruar të dhënat e mbrojtjes në ruajtje të padëmshme. Sistemi i skedarëve i shpërndarë në stilin UNIX ka veçori të integruara të kompresimit, enkriptimit dhe ç’dublikimit dhe integrohet pa probleme me infrastrukturën ekzistuese. Teknologjia ofron mbrojtje të shkallës ushtarake për sigurinë e informacionit në të gjitha nivelet. Për më tepër, veçoria e kutisë dixhitale mundëson hetime mjeko-ligjore pas çdo sulmi të sigurisë kibernetike.

Iliriana Kadri Sulkuqi-Fejzullai, është lindur në qytetin e Elbasanit, më 5 shtator të vitit 1951. Pasi mbaroi gjimnazin "Dhaskal Todri" në qytetin e lindjes (1969), vazhdoi studimet në Akademinë Ushtarake të Forcave Tokësore në Tiranë. Është diplomuar në vitin 1971.

Në vitet 1971-1995, ka qenë oficerë në Akademinë Ushtarake. Më pas, gazetare në shtypin ushtarak dhe në Shtëpinë Botuese të Ushtrisë. Gjatë kësaj periudhe ka mbaruar studimet për gjuhë-letërsi dhe filozofi. Mban gradën nënkolonel. Së fundi ka punuar si gazetare në gazetën "Drita", organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Aktualisht, jeton në SHBA-New York, (Brooklyn).

Ilirjana Sulkuqi ka këto vlerësime:

Më 24 shtator, 2009, në veprimtarinë "Poeteka 2009", është vlerësuar nga Bashkia e Qytetit të Elbasanit, me titullin: "Artist i Shquar i Qytetit", me motivacionin: "Për një kontribut të shquar e cilësor në krijimin e promovimin e vlerave artistike në fushën e poezisë, duke mbetur një qytetare e denjë e qytetit të Elbasanit". Më 13 mars 2018, nga Bashkia e Qytetit të Elbasanit i jepet titulli "Mirënjohja e Qytetit", me motivacionin: "Bijës së Elbasanit për poezinë e saj brilante e në lartësimin e vendlindjes". Qendra e Artit dhe e Kulturës Shqiptare, i jep titullin: "Princ i Artit dhe Kulturës Shqiptare", me motivacionin: "Për kontributin e saj të jashtëzakonshëm si poete, si promovuese e devotshme e kulturës Shqipe. Me lëvrimin e fjalës së pastër poetike dhe koncepteve të qarta artistike dhe humane, ajo ka lartësuar e ngritur në majat më të larta identitetin e artit dhe letërsisë shqiptare si dhe të autorëve tanë, duke e propaganduar Shqipërinë dhe Kulturën e saj në çdo skaj të botës". Në tetor 2011, Iliriana Sulkuqi është shpallur "Ambasador i Paqes", nga Federata Botërore për Paqen. Në Shkup, në vitin 2016, Iliriana Sulkuqi nderohet me titullin "Nënë Tereza" me motivacionin: "Reflektim i Mirësisë, i Paqes, i Dashurisë, për një kontribut të veçantë në art, Kulturë dhe Humanizëm". Për jetën dhe veprimtarinë e Iliriana Sulkuqit është realizuar një film dokumentar (shqip-anglisht) me autorë: Skenariste: Angjelina Xhara, operator: Ilija Terpini, (Mjeshtëri i Madh), regjisor: Kolec Traboini, (Mjeshtëri i Madh), reciton poezitë: Margarita Xhepa, "Artiste e Popullit".

Krijimtaria e Ilirjana Sulkuqit:

Ka filluar të shkruajë që në moshë të vogël. Kur ishte 9 vjeç, ka marrë çmim të parë Kombëtar, me tregimin "Vëllai", botuar në revistën "Pionieri" (1960). Është vlerësuar disa herë me çmime të para Kombëtare dhe Ndërkombëtare. Poezitë e saj janë përkthyer në disa gjuhë si: italisht, anglisht, greqisht, suedisht, maqedonisht, bullgarisht, arumanisht. Renditet në disa Antologji si brenda dhe jashtë vendit, si dhe në Enciklopedinë Shqiptare të Gazetarëve, në Leksikonë të ndryshëm. Është anëtare e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve nga viti 1974. Që nga 30.09.2003, është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (International Federation of Journalist-IFJ). Anëtare Nderi



e Organizatës Shqiptare Amerikane, "Motrat Qiriazit", (15 janar 2006). Anëtare Nderi e Shoqatës së Ushtarakëve në rezervë-Dega Athinë (13.04.2008). Anëtare Nderi e Shoqatës Atdhetare "Bijtë e Shqipes", Filadelfia (USA). Anëtare e Klubit të Shkrimtarëve të kudondodhur në botë "Drita", Athinë. Anëtare e Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë. Anëtare e Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve (5 janar 2006).

Libra të botuar:

"Më kërkojnë sytë e nënës"- (Sh. B "Naim Frashëri", 1974); "Ç'u fala stinëve që ikën" - (1988); "Të jesh grua"- (1990); "Do të jetoj"- ("Rozafa" 1996); "Trokite dhe zgjo"- ("Egnatia"-2000); "Ma vranë Ofelinë!...Oii...Oiiii...!" - italisht-shqip ("Toena"-2000); "Për një mollë që hëngri Eva..."- (NGB grafoprint, Prishtinë-gusht 2002); "(F) Shihemi në sy"- (janar-shkurt 2002); "Pulëbardhë në det' të zi" - ("Ilar"-maj 2002); "Lirika"- (Medaur-2003); "Hajku-bashkautorë"- ("Egnatia"-2004); "...Më kërkon falje", (Arbëria-2004); "Poezi (dy libra në Një)", "Snaj"-2007; "Qirinjtë e Galaktikës (The Candles of Galaxy)", "ADA"-2009; "Po Plas - vëll.1, (Egnatia), 2009; "Po Plas", vëll.2, (ADA-2016); "Jeta shëtit nëpër ëndrra", (ADA-2016); Tripit: "Sot Pagëzova Dashurinë", (Adonis-2018); "Ëndrra pa Semaforë", (Adonis-2018); "Takim me Pritjen - ("Adonis"-2018); "Aromë me ngjyra"-përsiatje dhe poezi të krijueseve të Elbasanit (Adonis-2018); "Fjalë për Nesër...", (Adonis-2019).

Botime të tjera në kolonën "Kujtesë":

Album Poetik "Kujto Poetin", me poetët e të gjitha trojeve, që nuk jetojnë më (bashkautore me K. Traboinin); Kalendar krijues: "Autorë të Fjalës së Shkruar" (art, kulturë, shkencë, pedagogji), të qytetit të Elbasanit; Libërthas "Kujtesë" kushtuar poetëve: "Betim Muço - Liria është si Bumerangu"; "Ndoc Gjetja - Poeti Krisht"; "Frederik Reshpja - Poeti i Vetmisë"; "Miliano Kallupi - Psherëtimë Hajku"; "Murat Isaku - Rrënjët". Ka në proces botimi, libërthas -Kujtesë për Martin Camajn, Qazim Shemajn, Bajazit Cahanin, Vasil Dede, etj.

Çmimet e fituara nga Ilirjana Sulkuqi:

Çmimi i tretë kombëtar për vëllimin poetik "Ç'u fala stinëve që ikën", (1988), në konkursin

me rastin e 45-vjetorit të Krijimit të Ushtrisë Popullore, organizuar nga Ministria e mbrojtjes dhe Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Çmimi i parë kombëtar (në poezi), në konkursin e shpallur me rastin e 45-vjetorit të revistës "Shqiptarja e Re" (15.8.1988). Çmimi i tretë kombëtar për vëllimin poetik dygjuhësh shqip-italisht: "Ma vranë Ofelinë!... Oiii...Oiiii...!", dhënë nga Ministria e Arsimit, Kulturës dhe e Sporteve si dhe Lidhja e Shkrimtarëve dhe e artistëve të Shqipërisë, në Ditët e Poezisë Shqipe "Lulet e Verës", maj 2001. Çmimi i Parë- për poezinë më të bukur për Dashurinë, në Ditët Poetike Ballkanike 2.06. 2002- Korçë. Çmim të veçantë në takimin ballkanik "Ditët e Asdrenit"-Shkup (2005). Çmimi i Parë- në takimin poetik "Pëllumbat e Bashtovës", akorduar nga Dega e Lidhjes se shkrimtarëve, Durrës, 4 tetor 2005. Çmimi "Migjeni" (2007) revista "Kuvendi"- Miçigan, SHBA. Çmimi "Ali Asllani"- liriku më i mirë i vitit (maj 2008), akorduar nga Ambasada Shqiptare në Athinë dhe Klubi i Shkrimtarëve Shqiptarë të kudondodhur në Botë "Drita", për vëllimin poetik "Poezi" (Më gjeni një titull...). Çmimi "Pena e Artë", dhënë nga Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë

Krijimtaria e Iliriana Sulkuqit është vlerësuar nga:

Dritëro Agolli - poet, shkrimtar, akademik; Perikli Jorgoni - studiues, kritik, përkthyes; Bedri Dedja - shkrimtar për fëmijë, akademik; Odhise Grillo- shkrimtar për fëmijë; Skënder Hasko - shkrimtar për fëmijë, Naum Prifti - shkrimtar, studiues; Anton Çefa - poet, shkrimtar, gazetar, analist (Amerikë), Pëllumb Kulla - Mjeshtëri i Madh, Faruk Myrtaj - shkrimtar, përkthyes; Dr. Klara Kodra - poete, studiuese, përkthyes; Dr. Fatmir Terziu - shkrimtar, gazetar, editor, analist, përkthyes (Londër-Angli), Nase Jani - poet, shkrimtar, botues, në Greqi, Lirim Deda - poet, publicist; Sokol Jakova - shkrimtar, kritik; Kolec Traboini - poet, skenarist; Nexhip Ejupi - poet, Dalip Greca - gazetar, editor i gazetës "Dielli" - New York; Rami Kamberi - kritik Maqedoni; Rrezarta Reçi - gazetare, publiciste; Vangjea Mihaj Steryu - poete, Kryetare e Lidhjes së Shkrimtarëve Arumunë; Nehat S. Hoxha - shkrimtar, studiues,

përkthyes, Prishtinë; Radije Hoxha - poete, gazetare në Radio Kosova, Prishtinë, Demir Gjergji - poet, shkrimtar, gazetar; Milianov Kallupi - poet, Aleko Likaj - shkrimtar, gazetar, kryetar i Klubit Hajkut Shqiptar; Fatime Kulli - poete, shkrimtare, gazetare, Dilaver Baxhaku - gazetar, Gladiola Bilbili - gazetare, TVSH; etj... Poezitë e Iliriana Sulkuqit, kanë hyrë në repertorin e zgjedhur të aktorëve të shquar si: Margarita Xhepa, Tinka Kurti, Violeta Manushi, Roza Anagnosti, Besa Imami, Demir Hyskja, Ismail Hodaj, Eduart Çala, Xhevat Limani, Ilir Borodani, Bujar Asqeriu, Justina Aliaj etj..

Në vazhdim, gjashtë poezi të Ilirjanës.

1- LETËR FËMIJËVE: "Sa të flini ju dhjetë herë,/ dhjetë përralla të tregoni/ dhe të zgjoheni dhjetë herë,/ dhjetë ëndërra të shikoni;/ sa të luani dhjetë herë,/ dhjetë këngë të këndonit...-/ ju vjen mami përsëri!/ Bëhem zog e vij tek ju./ Vij te ju e bëhem erë.../ Fluturoj në udhë pa fund,/ Veç zemra te ju t' më sjellë.../ (Budapest, Klinika Lasloz Korhaz, gusht 1989).

2- GRA, JU DUA...!: "...për natën, që ju bëri GRUA! / ...për dhimbjet (përtej dhimbjeve), / nga lindjet - JU Dua! / ...për Lotët e Fshehura, nga fshikëllima e Kohës-Ju Dua! / ...për pritjen që pret Pritjen-Ju Dua! / Për Paqen që i dhuron Botës-Ju Dua! / Për ngjyrat që ngjyroni NATËN.../Ju Dua! / Mos qoftë Zëri im, / Pa Shpirtin Tuaj!".

3- GJYSMAT E MIA... "Ca kilogram e ca, më peshon trupit, / ca numra e gjysmë, mbaj syzet.../ ca e gjysmë ca, këpucët.../ ku t'i gjej gjysmat?.../ S' më pëlqehet Fjala/ e thënë e pa thënë.../ S' më pëlqehet kënga / kur s' më bëhet Këngë! / S' më pëlqehet puthja, / dhënë pa u dhënë/ dhe askush pas gjysmës/ i fshehur pa frymë.../ S' më pëlqehet gjysma-/ Qoftë dhe gjysmë Hënë!".

4-NGA E GJETI KRIPËN DETI!?: "Nga e gjeti kripën deti, / ia dhamë ne a na e "vodhi"/ Se, me qindra mijëra vjet/ vetëm kripë nga lotët rrodhi.../ Det, dallgëzofsh pa stinë moti./ Det i mjaltë, u bëfsh moj Tokë./ Do të t'shtrijdh me gulçimë shpirti, / veç pranomë pa kripë në lot!".

5-MË KËRKOJNË SYTË E NËNËS!: "Më kërkojnë sytë e nënës/ Në çdo strofë, në çdo varg.../ Herë më sheh nëpër marshime, / Herë me shokët në repart./ Më kërkojnë sytë e nënës/ Në çdo rresht nëpër gazetë, / Kur lexon një reportazh- / -qenka mirë - thotë - me shëndet./ Paska shkuar në kufi.../ Njëherë tjetër ..., në Sazan./ Këtu, shkruan ime bijë -/ Ia them këngës me ushtarë.../ Nënë moj, ti jetën time/ Nëpër rreshta se ç'e ndjek/ Sa herë shkoj un' në shërbime, /Zëri yt nga pas më ndjek...".

6-DASHURIA IME - Një dhe Një e TËRË: "Dashuria ime:- jo vetëm për Fjalën.../ - jo vetëm për klithmën/ mbytur pa zë, / - jo vetëm një qarje/ për nënën, babanë.../ - jo vetëm për mallet, / motrën, vëllanë, / për miqtë, për miket/ për një fis të tërë.../ -jo për një qytet, / as një kontinent.../ -jo vetëm për Lindjen, / as dhe Perëndim.../ Dashuria ime:- jo vetëm një trill, / as dhe për një ëndërr/ me prekje pa zgjim.../ as ag' as prag, / as varr, as kalërim.../ Dashuria ime:- Jo vetëm një yll, / Hënë apo Diell..., / apo Afërditë.../ - Jo, as për një zog, / as dhe për një stinë.../ as veç për një lule, / qoftë dhe jasemin.../ - Jo veç për një rrap/ të lashtë sa bota, / as për një legjendë, / me tradhti nga brenda.../ Dashuria ime, / qenia e trupit tim/ (për të gjitha bashkë) :/ Vetëm një e tërë/ si puthje në vlim!?. (Brooklyn, NY, 3 shkurt, 2018)

Deklarata e 9 majit 1950 është data kur u hodh hapi i parë drejt krijimit të asaj që sot njihet si Bashkimi European. Ministri i Jashtëm i Francës, Robert Schuman, lexoi për shtypin ndërkombëtar një deklaratë ku i bënte thirrje Francës, Gjermanisë dhe vendeve të tjera europiane për të bashkuar prodhimet e tyre të qymyrit dhe çelikut që do të ishte “themeli i parë konkret për një Federatë të ardhshme Europiane”.



9 MAJI, DITA E EUROPËS

Europa, adresa ku na bashkon historia dhe përkatësia jonë shpirtërore

Europa ka dy ditë të shënuara, 5 majin, që njihet edhe si dita e Këshillit European dhe 9 majin, që është dita e Bashkimit European dhe ka ngelur nga data kur ministri i Jashtëm francez Shuman, bëri deklaratën e njohur historike.

Deklarata e 9 majit 1950 është data kur u hodh hapi i parë drejt krijimit të asaj që sot njihet si Bashkimi European. Ministri i Jashtëm i Francës, Robert Schuman, lexoi për shtypin ndërkombëtar një deklaratë ku i bënte thirrje Francës, Gjermanisë dhe vendeve të tjera europiane për të bashkuar prodhimet e tyre të qymyrit dhe çelikut që do të ishte “themeli i parë konkret për një Federatë të ardhshme Europiane”. Vendet të cilave u drejtohej thirrja kishin dalë të rrënuara materialisht dhe moralisht nga konfliktet me njëra tjetrën. Ajo që propozonte Schuman ishte krijimi i një institucioni european mbi-kombëtar, i cili do të administronte industrinë e prodhimit të qymyrit dhe çelikut, sektor i cili në atë kohë ishte baza e fuqisë ushtarake. Për këtë arsye dita e Bashkimit European njihet ndryshe edhe si Dita e Shumanit.

Vite më vonë, në Samitin e Milanos në 1957, kërret e BE-së vendosën që data 9 maj të shpallej dhe festohej si “Dita e Europës”. Ajo është një nga simbolet e Europës së Bashkuar.

Parlamenti European e njohu ditën e Europës sërish më 9 maj, në vitin 2008.

Dita e Europës festohet edhe në vendet që nuk janë ende pjesë e BE-së për të theksuar vlerat e këtij unioni, përhapjen e tyre në sistemin e edukimit. 9 maji festohet edhe në Shqipëri. Që nga viti 2003, edhe Ukraina e feston këtë ditë, gjatë një të shtune maji.

Megjithëse është e pranuar gjerësisht si Dita e Europës, ende disa grupe, mendojnë që 5 maji shpreh më mirë vlerat e demokracisë dhe barazisë mes popujve të Europës, ndërsa 9 majin e shohin si ditën e një marrëveshjeje mes Gjermanisë dhe Francës.

Motoja e BE-së është “Të bashkuar në diversitet”.

Himni i BE-së është Himni i gëzimit, “Ode to Joy” e Bethovenit.

Europa është fat. Është zgjedhje dhe zgjidhje. Është më shumë se gjeografi dhe jo më pak se një ëndërr. Europa është mohimi i një të shkuare të zymtë dhe historia e të ardhmes që pret ende të shkruhet.

Për ne shqiptarët, Europa nuk është qëllim në vetvete, por bindja se europianizimi i Shqipërisë është fati ynë i shkruar, zgjedhja dhe zgjidhja, adresa ku na bashkon historia dhe përkatësia jonë shpirtërore.



E dalë nga tmerri i një lufte botërore që nisi në Europë, atdheu i përbashkët i Shekspirit dhe Da Vinçit,

Gëtes dhe Hygoit, Servantesit dhe Kadaresë, shtetarët e saj të mëdhenj, kuptuan të vërtetën e madhe që bash-

këjetesa dhe jo agresioni, heqja e kufijve dhe vendosja përfundimtare e kufirit për luftërat e mundshme,

flamuri i përbashkët dhe krijimi i një hapësire unike për qytetarët që i bashkonte liria dhe dinjiteti njerëzor, pa perde të hekurt në mes, ishin e vetmja rrugë për të nesërmen. Çelik për të ndërtuar dhe jo për tanke që përdoren kundër njëri-tjetrit, e bënë edhe njërin, edhe tjetrin vend të Europës së Bashkuar më të mirë, më të fortë dhe më të begatë.

9 Maji, dita e Europës është rasti i lumtur për të kuptuar se paqja e fiton gjithmonë luftën! Ky është mesazhi i madh që jepet sot kur në kufijtë më Lindorë të Europës ka sërish bomba e raketa, tanke dhe tmerr që derdhen mbi një vend sovran, mbi gra e fëmijë dhe mbi luftëtarët e lirisë.

Ata që luftojnë në emër të së drejtës së një kombi për mbijetesë ndaj nazizmit të një udhëheqësi që jeton në të shkuarën, janë rimishërimi i atyre që po në nëntë maj të 77 vjetëve më parë, çliruan njerëzimin nga tragjedia e luftës.

Sot në Ukrainë luftohet për të nesërmen e Europës dhe gjithë botës. Ndaj sot Europa është më e fortë se dje si ide, si zgjedhje dhe zgjidhje.





NËNKOLONEL LIRIM HASA

Halil Mustaf Hasani ka lindur në fshatin Pistë të zonës së Malziut në vitin 1884, në një familje me origjinë patriotike dhe klerikale. Babai i tij quhej Mustaf, ndërsa e ëma Zarife. Halili ka pasur edhe tre vëllezër të tjerë, Ymerin, Maliqin dhe Hysenin. Dy nga vëllezërit e tij, Maliqi dhe Ymeri kanë qenë shkolluar si klerikë myslimanë dhe kanë shërbyer si imamë, njëri në fshatin Pistë dhe tjetri në fshatin Mamushë të Prizrenit.



Halil Mustaf Hasani, “MIC SOKOLI I MALZIUT”

Një histori e rrallë e trimërisë Shqiptare

Pista e Malziut është një perlë natyrore e minierë thesash, është dhe i kapedanëve, i lirisë e patriotizmit, në mbrojtjen shekullore nga sulmet e pushtuesve osmanë, austriake, serbë, malazezë, italianë etj. Pista ka bërë pjesë në njërin nga 7 bajrakët e Pukës dhe është quajtur Nahija e Spasit, por që nga fundi i shekullit të 17-të ka marrë emrin “Dheu i Malziut” ose “Malziu”, emërtim i cili sipas studiuesve, është vënë për shkak të pyjeve të shumta, kryesisht me pishë të zeze (pinus nigra). Mendohet se banorët e parë në Pistë të Malziut, kanë ardhur aty nga fundi i shekullit XIV nga Beri-sha e Mërturit të Pukës. Ato ishin katër vëllezër: Nik Pali, Kurt Pali, Brah Pali dhe Ahmet Pali, që ndër shekuj ata u shtuan dhe u bënë një shat i madh që krahas punës kanë mbajtur mbi supe pushkën dhe kanë bërë histori. Ngjarja më kulmore e historisë së Pistës e pistorëve të Malziut është qëndresa e tyre në luftën për liri e pavarësi në vitet 1912-1913 si dhe akti heroik i Halil Hasanit, njeriut që projektoi, ndërtoi dhe luftoi me top druri, duke goditur tri herë pushtuesit serbë, një histori e veçantë e trimërisë shqiptare.

Halil Mustaf Hasani ka lindur në fshatin Pistë të zonës së Malziut në vitin 1884, në një familje me origjinë patriotike dhe klerikale. Babai i tij quhej Mustaf, ndërsa e ëma Zarife. Halili ka pasur edhe tre vëllezër të tjerë, Ymerin, Maliqin dhe Hysenin. Dy nga vëllezërit e tij, Maliqi dhe Ymeri kanë qenë shkolluar si klerikë myslimanë dhe kanë shërbyer si imamë, njëri në fshatin Pistë dhe tjetri në fshatin Mamushë të Prizrenit. Ndërsa vëllai i fundit është marrë me bujqësi, blegtori si dhe me punët e shtëpisë. I ati, që në moshë të re konstatoi se Halili kishte aftësi të veçanta, prandaj e mbante gjithnjë afër vetes si në punët e shtëpisë, gjueti, dasma e lojëra popullore, oda apo në kuvende burrash. Me kalimin e viteve, Halili u rrit dhe u martua me Havën, motrën e Ismail Afirit, një tjetër luftëtar i madh që ishte nga derë e madhe në fshatin Vaspas. Më pas erdhi momenti kur Halili vendosi të shërbente në ushtrinë osmane, ndaj dhe falë inteligjencës dhe aftësive praktike, ai u përzgjedh dhe u përgatit në kompaninë e artilerisë, i cili pastaj shërbeu si “Komandant Artilerie” për më shumë se tre vite. Në këtë kohë, me situatën e krijuar me marrjen e pushtetit nga turqit e rinj, me fillimin e kryengritjeve të përgjithshme shqiptare, por dhe me fillimin e luftës ballkanike, bëri që Halili të kthehej në atdhe si shumë patriotë të tjerë, për të mbrojtur trojet amtare nga një plan djallëzor, pushtimi e copëtimi nga aleanca serbo-malazezo-bullgaro-greko-ruse. Kështu, pra, më 30 tetor 1912, Mali i Zi me 30 mijë trupa, i mbështetur nga Serbia, u fut në qyte-



tin e Shkodrës për ta pushtuar, por me synimin final daljen në detin adriatik.

Në këtë situatë, 24 mijë forca turke me komandant Hasan R. Pashën dhe me 15 mijë rezervistë shqiptarë me komandant Esat Pashën, mbrojtën për 6-muj rresht kalanë dhe qytetin e Shkodrës, ku në këtë mbrojtje mori pjesë edhe artileri Halil Hasani së bashku me 60 malzias. Në këtë kohë në fushën e Shtojit dhe në Bërdicë, ku po zhvilloheshin luftime të ashpra, në betejë e sipër Halili u plagos, çka e detyroi të mjekohet për tre javë nga mjekët popullorë. Për këtë akt heroik Halili është dekoruar nga Presidenti i Republikës me urdhrin “Për veprimtari patriotike të klasit të dytë”, me motivacionin “Luftëtar i shquar” në mbrojtjen e qytetit të Shkodrës nga pushtuesit serbo-malazes, në vitet 1912-13, në datën 03.06.1993 me dekret nr. 547. Në vijimësi të kësaj kohe, Halili u gjend para një situatë të re. Më konkretisht në datën 10 nëntor 1912 divizioni serb “Drini 2” i dislokuar në Gjakovë u urdhërua që të sulmonte Shqipërinë dhe përmes luginës së Drinit të mbërrinte në Shëngjin.

Në vijimësi të këtij sulmi, e marrë edhe nga ana historike, ka diçka shumë domethënëse, se afër Beogradit rreth 18 km ka qenë muzeu i “Kralave”, ku këtu ruheshin 3 poçe me dhe, të marra nga Kulla e Lumës dhe nga zona e Spasit. Ato ruheshin me mbishkrimin, kujtoni Kullë-Lumën dhe Golgothenë e Spasit. Kjo është një porosi që iu lihej nipërve dhe mbesave të serbëve të vranë, për t’u hakmarrë. Gjithsesi, divizioni “Drini 2”, i cili do të sulmonte Shqipërinë,

ka pasur një efektiv prej 9219 vetësh, të pajisur me armatim modern për kohën, përfshirë 7 batalione këmbësorie, 10 topa malorë, 12 mitraloza, 2 eskadronë, 2 çeta të xhenios, etj. Nga Gjakova serbët kaluan në Has, Qaf-Prush, Golaj, Krumë dhe përmes Urës së Vezirit sulmuan fshatrat e krahinës. Kështu në fshatin Pistë ishte ngritur dhe vepronte çeta e Halil Hasanit, në Spas çeta e Ismail Arifit dhe në Shikaj çeta e Beq Hoxhës, ku me thirrjen “7 e më 70 të gjithë të mbrojmë atdheun nga pushtuesit serb” u ngritën në këmbë i madh e vogël. Pra, siç e theksova më lart, në fshatin Pistë ishte ngritur dhe vepronte çeta e Halil Hasanit, ku mund të përmend disa nga shokët e tij si:

Haxhi Ibrahim, Maliq Mustafa, Hasan Alia, Sadik Rama, Hysen Mustafa, Zymer Velia, Rexhep Hyseni, Mustaf Alia, Rrustem Uka, Ymer Mustafa, Isuf Ibra, Muzli Bajrami, Sheqer Elezi, Zeq Tahiri etj. Luftimet kanë vazhduar ritmikisht në të gjithë zonën me burra dhe gra, në çfarëdo lloj arme që mund të kishin si kmesa, sakica etj. Gjithsesi nga ana e serbëve, u bë djegia e shtëpive, fshatrave të shoqëruara me masakrimin barbarisht të 70 vetëve (burra, gra, pleq, plaka, si dhe fëmijë në djep, të cilët serbët i kanë therë me bajoneta si bagëtitë) në fshatin Pistë, Gdheshë dhe në Mgullë. U plaçkitën shtëpitë, pasuritë, e çdo gjë që gjendej mbi tokë. Malziut iu vu zjarri. Si rrallë në ndonjë krahinë tjetër në Shqipëri u dogjën dhe u bënë shkumb e hi fshatra të tëra si Pista, Gdheshta, Spasi, Mgulla dhe Kryema-

dhi. Çfarë masakre për një krahinë të tërë që luftoi për mbrojtjen e trojeve të veta. Ata që mundën të shpëtonin nga përndjekja, u strehuan tek të parët e tyre në Brigjet e Drinit të Zi. Këto luftime të ndërmarra prej tyre, zgjatën disa muaj duke kulmuar me luftën heroike e qëndrestare të çetës së Pistës me udhëheqësin legjendar Halil Hasanin.

Në vijim të kësaj kohe, nisur dhe nga situata e krijuar, Halil Hasani ftoi në një kuvend burrat më të mençur e më trima pistorë pse jo edhe malzes, të cilëve u foli mbi masat që duheshin marrë, si dhe ndër të tjera u propozua që pushtuesit serb të pritej edhe me top. Por, kush do ta bënte? Pas shumë konsultimesh u vendos që topi të bëhej me mjete rrethore, sipas projektit të hartuar nga komandant Halil Hasani dhe konkretisht u zgjodh druri i dardhës së egër si druri më i fortë. Kështu së bashku edhe me 12 pistorë, ai ndërtoi “Topin e dardhës”. Sipas projektit, topi u realizua me një gjatësi 1.2 m dhe u shtrëngua me 12 rrethë çeliku, të cilët u përgatitën nga Preng Kovaçi i Kryeziut të Pukës. Municioni ishte, 3 mushka me barot e dhjetëra gjyle për mbushjen e topit. Topi i dardhës ishte një shpikje popullore që rrallë ose pothuajse asnjëherë nuk ka ndodhur në vendet e tjera.

Halili, “Topin e dardhës” e vendosi në Kodër-Kuqël të Pistës për ta pasur në kontroll gjithë hapësirën dhe lëvizjet e armikut. Ndaj, qitja e parë me top e pistorve u dëgjua në gjithë krahinën, e cila rezultoi mjaft e suksesshme për



luftëtarët e lirisë, ku këtë ngjarje popullore e ka përjetësuar me vargjet e këngës:

“Halil Hasani, burr’dragu, “Topin dardhës” e ka mbaru / Populli i Pistës kaba gajret / ka luftu me top të vet...”, pasi ndërtimi i një topi prej druri është një vepër, në mos unike, tejet e rrallë ndër shqiptarë. Lufta vazhdoi me tej... ku goditja e dytë pati jehonë të madhe, e

cila rriti klasin e qëndrestarëve për liri. Kur Halili përgatitej për qitjen e tretë, ai piskati me të madhe: “Ooooo prite serb topin e dardhës”, duke tronditur thellë serbët. Në momentin e shtënies së tretë nga komandant Halili, nga njëra anë, por dhe nga serbët nga ana tjetër (të cilët po qëllonin pa pushim) ndodhi përplasja fatale me topin e dardhës. Topi në fjalë, duke qenë i tej mbushur dhe i tej nxehur, mori flakë sa u hapën edhe rrahët. Si pasojë, u dogj së gjalli edhe komandant Halili së bashku me topin.

Ai ra heroikisht si bien trimat përballë armikut në mbrojtje të pavarësisë së sapo shpallur, në mbrojtje të flamurit dhe atdheut duke bërë histori, ç’ ka për atë kohë përbërë një vepër tejet të rrallë për gjithë shqiptarët.

Halil Hasani, është një figurë e rrallë jo vetëm e Malziut, por e tërë krahinës së Lumës, Hasit, Kukësit dhe më gjerë. Akti i tij nuk harrohet as në traditën popullore e as në historinë kombëtare. Por për arsye të luftës së klasave, akti i tij i është dhënë padrejtësisht dikujt tjetër ku në vend që të vlerësohej e dekorohet Halil Hasani, dekorohet Preng Kovaçi. Për vite të tëra kjo histori është interpretuar dhe shkruar mbrapsht për interesa të dikujt tjetër, por që mbas viteve ’90 edhe ata që e kanë bërë këtë gabim, janë përpjekur dhe gati diku e kanë korrigjuar atë. Pra, heroizmi i gjithë pistorëve dhe i prijësve legjendar Halil Hasani si komandant çete dhe dëshmor i rënë në luftën për liri dhe pavarësinë në 1913, bëri atë që në vitin 1993 të dekorohet mbas vdekjes nga Presidenti i Republikës me urdhrin “Për veprimtari patriotike të klasit të parë”, ndaj pushtuesve serb në 1913.

Për heroizmin e Pistës dhe pistorëve të Malziut, për aktin heroik të kapuç-bardhit Halil Hasani, ideuesit, ndërtuesit dhe autorit të një topi primitiv, kanë shkruar shumë studiues të ndryshëm si: Dr. Vangjel Kasapi; “Mjeshtër i Madh” Xhemal Meçi; studiuesit Sami Ferizi; Ali Hasani; Ukë Sinani; Hasan Alia; Hysen Shehu; Shaban Hasani; Bajazit Cahani; Bardhyl Mezini, etj. Kanë bërë piktura autorët si: Alaudin Tabaku; Agim Bido; Pjetër Marku; Denisa Meçe, etj. Kjo luftë do të mbetet unike në llojin e saj, për vetë faktin se aty u përtërit tradita e lashtë e luftës çetnike si dhe e ndërtimit dhe goditjes me një top prej druri nga Halil Hasani, që populli e quan “Mic Sokoli i Malziut”.

* *Oficer Shtabi për Skenarët Strategjik/Operacional dhe Vlerësim Mbrojtje IKSHU, AFA*

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Aleatët dhe Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore
(Në kuadrin e 9 majit, ditës së fitores mbi fashizmin)Pushtimi fashist dhe njohja e
qëndresës së popullit shqiptar

7 prilli 1939 ishte dita e parë e pushtimit fashist, por edhe dita e parë e rezistencës së armatosur antifashiste e popullit shqiptar. Pushtimin nga Italia fashiste populli shqiptar e priti me armë në dorë. Megjithëse me një qëndresë të paorganizuar, të pak formacioneve të ushtrisë mbretërore nën mbështetjen e patriotëve dhe vullnetarëve popullorë, kjo rezistencë tregoi se populli shqiptar e urrente fashizmin. Në vitet e para të pushtimit fashist (1939-1941), qëndresa pati kryesisht karakter spontan por, ajo po përgatiste shtratin e shëndoshë për një rezistencë të organizuar për të ardhmen. Krijimi i forcave politike dhe veçanërisht i Frontit NÇ, e cila përqafoi dhe propagandoi idenë e luftës së armatosur kundër pushtuesve bëri që gjatë vitit 1942, veprimtaria e njësiteve guerile dhe çetave partizane po tronditën seriozisht pushtuesit fashist.

Më 16 shtator 1942, u mbajt Konferenca e Pezës, e cila i dha impulse të mëdha lëvizjes dhe qëndresës luftarake kundër pushtuesve të huaj. Platforma e saj pluraliste po jepte shpresat për një bashkim gjithëpopullor në luftë. Krijimi i Frontit Nacionalçlirimtar rriti jo vetëm moralin e popullit shqiptar për luftë, por njëkohësisht iu tregonte vendet demokratike perëndimore e veçanërisht aleatëve të mëdhenj: SHBA, Angli dhe BRSS, se lëvizja e armatosur në Shqipëri ishte një lëvizje e organizuar dhe e drejtuar. Pas Konferencës së Pezës kemi një rritje të ndjeshme të grupeve dhe njësiteve guerile në qytete por sidomos rritje të veprimtarive të çetave partizane dhe atyre territoriale në zonat fshatare. Kjo situatë e re politike e krijuar në vend dhe veçanërisht veprimet e suksesshme të armatosura fituan simpatinë dhe vëmendjen e aleatëve të cilët shikonin te lufta për çlirim dhe popullit shqiptar një aleat në luftën e përbashkët kundër fuqive nazifashiste të Luftës së Dytë Botërore.

Komanda e përgjithshme e Fuqive aleate në Mesdhe po vlerësonte seriozisht dobinë që do t'i sillte realizimit të objektivave të tyre politiko-ushtarak dhe lëvizja nacionalçlirimtare e popujve të Ballkanit. Në këto kushte, më 18 dhjetor 1942 aleatët e mëdhenj, SHBA, Angli dhe BRSS nëpërmjet ministrave të jashtëm Cordell Hull (SHBA), Molotov (BS) dhe Anthony Eden (Angli), nënshkruajnë një deklaratë të përbashkët. Me fjalë falënderimi ata vlerësojnë luftën dhe qëndresën e popullit shqiptar duke deklaruar njohjen e Luftës Antifashiste dhe shprehjen mbështetjen e saj si pjesë përbërëse e luftës së përbashkët kundër vendeve të bllokut nazifashist. Deklarata Hull-Molotov-Eden përbënte një fitore të madhe për popullin shqiptar. Ajo e rreshtoi vendin tonë në krah të aleatëve të mëdhenj dhe njëkohësisht hodhi poshtë pretendimet se Shqipëria ishte pjesë e boshitit famëkeq nazifashist. Deklarata e fuqive aleate, ngjalli shpresa të mëdha dhe inkurajoi më tepër lëvizjen për çlirim të popullit shqiptar. Pas kësaj forcat aleate filluan aksionet konkrete për marrjen e kontaktit me lëvizjen nacionalçlirimtare shqiptare. Në shtator 1943 Wiston Churchill duke iu përgjigjur pyetjes së një deputeti në dhomën e komuneve deklaroi lajmin se armatat e aleatëve perëndimorë kishin hyrë në kontakt me forcat çlirimtare në Shqipëri. Duke deklaruar se "Oficerët britanik që kanë hyrë në marrëdhënie me guerilet shqiptare, kanë shfaqë admirim për vetitë e tyre luftarake. Ne presim që shqiptarët duke ndjekë traditat e tyre të lashta, të lozin rolin e tyre për suksesin e operacioneve luftarake në frontin e Mesdheut".

Shtabi i Mesdheut dhe misionet britanike

Edhe pse për herë të parë misioni ushtarak anglez vjen në Shqipëri në verën e vitit 1943, interesimi i anglezëve kishte filluar me herët. Në korrik 1940 Çerçilli kishte hedhur idenë "Për të ndezur zjarrin në Europë". Në prill të vitit 1941, rreth 300 shqiptarë nën udhëheqjen e vëllezërve të dëgjuar kosovarë, Kryeziu, monarkistit Abaz Kupi dhe komunistit Mustafa Gjinishi të shoqëruar nga nënkoloneli anglez Okley Hill, shefi i seksionit SO2 në Beograd dhe ish-instruktori i xhandarmërisë në kohën e mbretit Zog, organizuan një kryengritje kundër italianëve në Shqipërinë e veriut. Për shkak të masave të dobëta organizative kryengritja dështoi por ajo tregoi interesa dhe mbështetjen e anglezëve kundër pushtuesve italianë në Shqipëri.

Interesimi i rritur i anglezëve për rezistencën në Ballkan kishte një arsye tjetër objektive. Nga fundi i vitit 1942, lufta kishte arritur në pikën e kthesës. Në këto rrethana, një grup prej katër ushtarakësh anglezë të kryesuar nga Majori Maclean, i cili kishte pasur një eksperiencë të mirë të luftës guerile në Palestinë dhe Abisini; Kapiteni David Smajji; Togerit xhenier Geri Defi dhe rreshteri me origjinë skoceze Williamson, në pranverën e vitit 1943 hyn në kontakt me Ushtrinë Nacionalçlirimtare në jug të vendit. Takimi i parë u bë nga Bedri Spahiu dhe pas një udhëtimi të gjatë ky mision atashohet pranë Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH. Mërritja e misionit të parë bëri të mundur që shpejt qeveria angleze të krijojë një tjetër pamje për luftën dhe Lëvizjen Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar. Nga raportet e dërguara prej grupit të oficerëve anglezë të atashuar pranë Ushtrisë Nacionalçlirimtare, Qendra SOE në Londër bënte "përmbledhje dyjavore" (korrik 1943), ku thuhej se "Kemi lajme të mira nga Shqipëria. Shërbimi SOE-së për Shqipërinë është vënë në vijë dhe guerilet shqiptare janë po aq aktive dhe anti-italiane sa ç' është njoftuar". Njohja nga afër e objektivave të luftës së popullit shqiptar rriti më tej jo vetëm interesimin dhe mbështetjen, por strukturat e misioneve ushtarake angleze u shtuan duke u vendosur jo vetëm pranë Shtabit të Përgjithshëm, por edhe në disa komanda të disa njësiteve të mëdha të UNÇSH. Pranë Shtabit të Përgjithshëm gjatë Luftës Nacionalçlirimtare



vepruan tre misione britanike. Pavarësisht se fillimisht marrëdhëniet midis misioneve ushtarake angleze dhe luftës së popullit shqiptar reflektuan ngarkesa politike për shkak të forcave të ndryshme politike që vepronin në vend, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së i mirëpriti këto misione me përzemërsi. Tek këto misione ai shihnte mundësinë për mbështetje e furnizime me materiale luftarake për shkak të nevojave gjithnjë e në rritje të formacioneve luftarake partizane, si dhe mbështetjen si një faktor tepër i rëndësishëm politiko-ushtarak siç ishte Anglia në kuadër të aleatëve të mëdhenj së bashku me SHBA-të dhe BRSS. Përputhja e qëllimeve strategjike dhe objektivave të luftës përbënin bazën për një bashkëpunim e bashkëveprim efektiv midis UNÇSH-së dhe komandës së forcave aleate të Mesdheut. Komanda aleate ishte e interesuar që në Ballkan të bllokoheshin sa më shumë forca armike e të krijoheshin sa më shumë zona të lira në thellësi të territoreve apo në bregdet për t'i pasur ato si objekte mbështetëse për operacione zbarkimi në të ardhmen. Veprimet e suksesshme të UNÇSH-së veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit 1944 për bllokimin dhe asgjësimin e kolonave gjermane të cilat tërhiqeshin nga Greqia e Veriut, në kuadër të tërheqjes së tyre strategjike nga Ballkani, ishte një ndihmesë e vlerësueshme për forcat aleate. Së bashku me objektivat e Mësymjes së Përgjithshme që UNÇSH zhvilloi prej qershorit deri në nëntor 1944, këto veprimtari të suksesshme ishin në pajtim dhe interes të plotë të objektivave strategjike të aleatëve për Ballkanin perëndimor.

Misioni ushtarak amerikan

Pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare u vendos edhe një mision ushtarak amerikan. Misioni ishte i përbërë nga tre veta dhe drejtohej nga togeri me origjinë shqiptare Thomas Stefan. Detyra e këtij misioni ishte të vendoste e të mbante ndërlidhje midis UNÇSH dhe Ushtrisë Amerikane, si dhe të informonte për zhvillimet e luftës e të formacioneve luftarake shqiptare. Shtetet e Bashkuara të Amerikës po i ndiqnin me vëmendje ngjarjet në Shqipëri. Duke vlerësuar këto zhvillime qeveria amerikane nëpërmjet ministrit të saj të Jashtëm Cordell Hull, me rastin e ditës së Flamurit më 1943 i dërgoi popullit shqiptar një mesazh radiofonik ku theksonte: "Qeveria dhe populli i Shteteve të Bashkuara kanë ndjekë me interesim të gjallë luftën e popullit shqiptar për të ruajtur pavarësinë dhe tërësinë tokësore të atdheut të tij. Ne kemi vëzhguar me simpati dhe admirim rezistencën tuaj kundër invadorit fashist dhe vendosmërinë tuaj për të jetuar të lirë në vendin tuaj". Togerit Thomas Stefan mori pjesë edhe në Kongresin e I Antifashist Nacionalçlirimtar që u mbajt në Përmet në maj 1944, me ftesë të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH.

Shqipëria në pozicion të prerë antifashist

Ndihmesa e popullit shqiptar në krah të Aleatëve të Mëdhenj për fitoren mbi fashiz-

min dhe kostoja që ai pagoi për këtë është tepër e ndjeshme. Populli shqiptar, nën udhëheqjen e Frontit NÇ, radhitjen e tij në krah të Aleatëve të Mëdhenj nuk e pa thjesht si një aderim apo solidarizim e aq më pak për ta pasur si një kartë për ta tundur në përfundim të luftës. Në të kundërt, besnik i traditave të të parëve të vet, ai këtë renditje e shikonte dhe e zbatoi, pa as më të voglin hezitim, si një detyrim e angazhim moral e atdhetar për të renditur në frontin e përbashkët gjithë potencialet morale, njerëzore, materiale e luftarake. Dhe ai, në sajë të ndihmesës së çmuar në shkallë ndërkombëtare, arriti me dinjitet ta radhis veten në ballin e qëndresës antifashiste e në krah të fitimtarëve. Ky pozicionim i prerë antifashist ishte njëherazi edhe një ndihmesë në ruajtjen e tërësisë territoriale të shtetit shqiptar të pas luftës, të rrezikuar nga lakmitë e shteteve shovene fqinje. Është ajo luftë dhe sakrificat mbinjerëzore që bënë brezat e shkuar që na japin sot krenarinë kur dëgjojmë që vendi jonë radhitet ndër të parët dhe përfaqësues të tij edhe dekorohen nga të huajt për merita në këtë luftë. Përulemi me

respekt ndaj gjithë atyre që bënë LANÇ dhe brezave që përballuan me dinjitet peshën e rëndë të saj. Është meritë e padiskutueshme e atyre organeve e personaliteteve politike e ushtarake që udhëhoqën LANÇ, të cilët ditën të vendosin e të ruajnë raporte të drejta mes faktorit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar në këtë luftë për jetë e vdekje. Agjencia Rojter, më 1 nëntor 1940, deklaronte se: "...mobilizimi i Shqipërisë dështoi krejtësisht". Dhe kjo nuk erdhi rastësisht apo sikurse vepronin forca të caktuara politike që qëndronin në heshtje apo edhe duke e përkrahur intensivisht pushtuesin e duke iu kundërvënë LANÇ-it. Ishte një veprimtari e tërë e atdhetarëve, komunistëve, fetarëve, rinisë, gruas shqiptare që edhe pse nën terrorin fashist, ditën të organizohen dhe të bëjnë të dështojë çdo përpjekje e tyre por edhe e bashkëpunëtorëve dhe shërbëtorëve besnikë për të kthyer fletën e luftës.

Shqipëria nxori rreth 70 000 luftëtarë të përfshirë në 24 brigada, 8 divizione dhe 3 korparmata. Konferenca historike e Bujanit i dha një zhvillim të madh Lëvizjes NÇ edhe në Kosovë, ku u krijuan 9 brigada partizane dhe rreth 53 000 luftëtarë. Në luftime e operacione të ndryshme në Shqipëri u vranë 28 000 dëshmorë, krahas rreth 20 000 qytetarëve të masakruar, vranë e gjymtuar nga pushtuesit fashistë e nazistë. Në territorin shqiptar shkeli këmba e më së 700 000 trupave nazifashiste dhe u angazhuan rreth 15 divizione italiane e gjermane duke iu nxjerrë jashtë luftimit rreth 70 000 trupa. UNÇSH plotësoi më së miri misionin që mori mbi vete duke çliruar vendin pa qenë e nevojshme që në truallin e saj të futeshin formacione ushtarake të forcave aleate. Kjo përbën, në pamjen luftarake, ndihmesën e drejtpërdrejtë të popullit shqiptar në kuadër të Koalicionit të Madh Botëror Antifashist. Shqipëria mbajti kështu një peshë të rëndë në raport me popullsinë.



Studentët shqiptarë, krenaria jonë përtej oqeanit



Ministri Peleshi jep lajmin e mrekullueshëm nga SHBA, toger Rudens Kagjini përfundoi me rezultate ekselente kursin e ndërlidhjes në "US Army Signal School", (Qendra e Ekselencës për Siguri Kibernetike). Eksperienca e Toger Kagjinit do i vlejë pa diskutim shtimit të profesionalizmit të skuadrës sonë të mbrojtjes kibernetike, që përmirësohet çdo ditë, jo vetëm në infrastrukturë por edhe në ekspertizë.

